



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

AIDA MYRTO

Aida Myrto është emëruar Drejtore e Përgjithshme e Qendrës së Shërbimeve Arsimore në janar 2025. Ajo sjell në këtë rol një përvojë të gjerë në politikat arsimore, menaxhimin institucional dhe zhvillimin e sistemeve të sigurimit të cilësisë dhe njohjes së kualifikimeve. Përpara këtij emërimi, znj. Myrto ka shërbyer si Këshilltare e Ministres së Arsimit dhe Sportit për politikat e arsimit të lartë (2024–2025), si dhe si eksperte e nivelit të lartë në Sekretariatit Shqiptar të Procesit të Bolonjës (2021–2024), ku luajti një rol kyç përgjatë të gjithë procesit si dhe në përgatitjen dhe organizimin e Ministerialit Europian të Arsimit të Lartë në Tiranë në maj 2024.

Znj. Myrto ka përvojë të gjerë akademike dhe teknike në fushën e didaktikës dhe mësimdhënies digjitale. Ajo është specialiste e mësimdhënies online dhe në distancë, me mbi 3 000 orë formim të certifikuar nga universitete të njohura spanjolle, përfshirë UNED-in, Universitetin e Salamancës dhe Universitetin “Antonio de Nebrija”. Në vitin 2020 ka kontribuar në grupet kombëtare të punës për përmirësimin didaktik të platformës së mësimdhënies në distancë dhe në konceptimin e platformës së formimit të vazhdueshëm online për mësuesit.

Aida Myrto ka një profil të konsoliduar ndërkombëtar, të ndërtuar përmes angazhimit në rrjetet europiane të arsimit të lartë dhe njohjes së kualifikimeve, ku ka udhëhequr analiza politike, negociime teknike dhe harmonizime me standardet e Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA) dhe Konventën e Lisbonës për Njohjen. Ajo është folëse në dhjetëra konferenca akademike dhe profesionale dhe autore e disa përkthimeve.

Znj. Myrto mban një diplomë në Gjuhë dhe Mësimdhënie të Gjuhës Frënge nga Universiteti i Tiranës (2005), një MBA të përbashkët nga Universiteti Politeknik i Tiranës dhe Universiteti “Bordeaux Montesquieu” (2007), si dhe një Master (2011) dhe titullin “Doktor i Shkencave” (2016) në Didaktikën e Gjuhës Spanjolle si Gjuhë e Huaj nga Universiteti “Pablo de Olavide” në Sevilje. Ajo zotëron shumë mirë gjuhën frënge, angleze, spanjolle dhe italiane, si dhe ka njohuri të gjuhës greke dhe portugeze. Për më shumë se një dekadë, ajo është pedagoge e jashtme e gjuhës spanjolle në Universitetin e Tiranës.